



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË**

Numri i lëndës: 2022:211273

Datë: 22.12.2022

Numri i dokumentit: 03790302

**PPP. nr. 1/20**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, Gjyqtari për përmbarrim Nehat Qelaj si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen përmbarrimore të kreditorit K.R.U. “H.J.”, Sh.A, rr. ‘W. C.’, Njësia në P., ndaj debitorit R. Z. M. nga M.- Rr.”J. M. M.”, për propozim për përmbarrim, për borxh, vlera 469.10 €, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, ushtruar kundër Urdhërit për Lejimin e Përmbarrimit P.nr.131/2019 të datës 02.12.2019 të Përmbarruesit Privat Ymer Kastrati nga Malisheva gjykata jashtë seancës, më datën 22.12.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Prapësimi** i debitorit R. Z. M. nga M.- Rr.”J. M. M.”, i paraqitur kundër Urdhërit P.nr.131/2019 të datës 02.12.2019, mbi lejimin e përmbarrimit **REFUZOHET si i PA BAZUAR**.
- II. MBETET NË FUQI** urdhëri, P.nr.131/2019 të datës 02.12.2019, me të cilin është caktuar përmbarrimi, sa i përket shumës së borxhit prej 469.10 Euro.
- III. Ankesa** kundër këtij Aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarrimore, për veç nëse janë dhënë garancitë në shumën e plotë të detyrimit në të holla, në të kundërtën konsiderohet se ankesa nuk është paraqitur fare.

**A r s y e t i m**

Kreditori K.R.U. “H. J.”, Sh.A, rr. ‘W. C.’, Njësia në P., më dt.29.11.2019, ka parashtruar propozim për përmbarrim, kundër debitorit R. Z. M. nga M., te përmbarruesi privat Y. K. nga Malisheva, duke kërkuar që në emër te borxhit të faturuar për muajin e 10.2019 ta paguaj borxhin në shumën prej 469.10 euro.

Përmbauesi privat, Ymer Kastrati me seli në M., me urdhër përmbaues P.nr.131/2019 të datës 02.12.2019, ka lejuar përmbauesin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbauesore.

Kundër Urdhërit me të cilin është caktuar përmbauesi, debitori ka paraqitur prapësim më datën 27.12.2019 (datë e protokolluar tek përmbauesi), më të cilin ka theksuar se përmbauesi gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike pasi që propozimin e ka mbështetur vetëm në mënyrë paushallë dhe është e pa mundur që për muajin e 10 të 2019 të ngarkohet borxhi në vlerën 469.10 euro, me çka në këtë rast kemin shkelje të Ligjit Përmbauesor dhe vjetërsim të borxhit, gjykatës i ka propozuar të aprovojë prapësimin si të bazuar, dhe ta hudhë urdhërin përmbaues.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim me të cilin ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pa bazuara nga arsyeja që kreditori ka si dëshmi kartelën e klientit dhe faturën si dokumente të besueshme sipas nenit 37 të Ligjit për Procedurën Përmbauesore, ku shihet që borxhi total i debitorit ndaj kreditorit është shuma e lartcekur, gjykatës i ka propozuar refuzimin e prapësimin si të pa bazuar duke e detyruar debitorin të përmbush detyrimin e pagesës së borxhit në emër të ujit të shpenzuar si dhe shpenzimet e procedurës.

Duke vlerësuar prapësimin e debitorit Gjykata gjeti se i njëjti është i pa bazuar.

Sipas nenit 71 të LPP-së, të Ligjit nr. 04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 3 të datës 31.01.2013, më tej LPP), janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi e të cilat shkaqe po që se ekzistojnë, pengojnë përmbauesin e lejuar nga gjykata. Gjykata vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbauesin e lejuar, në fakt dokumenti mbi të cilin është mbështetur Aktvendimi mbi lejimin e përmbauesit ka titull ekzekutiv (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1), dokumenti përmbaues (titulli ekzekutiv) nuk ka humbur efektin e tij me ndonjë vendim tjetër institucional, (neni 71. Paragrafi 1 nën paragrafi 1.2) në bazë të cilit është marr me aktvendim përmbaues nuk është prishur, anuluar apo ndryshuar, shfuqizuar në një mënyrë të tjetër dhe nuk e ka humbur efektin e tij juridik, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3) palët për mes dokumentit përmbaues janë pajtuar që ti kryen obligimet e tyre për kohe të caktuar, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4) nuk ka skaduar afati kohor ku palët mund të kërkojnë përmbauesin, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5) objekti i përmbauesit nuk është i përjashtuar nga përmbauesi i detyrueshëm, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6) kreditori është i autorizuar që në bazë të dokumentit përmbaues të kërkojë përmbauesin kundër debitorit, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9) realizimi i kredisë nuk është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër në mënyrë të përhershme ose për periudhën e kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk ka mundur të bënte të njohur në procedurë në të cilin është nxjerrë vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdie në Gjykatë ose në organin administrativ, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10) kërkesa nga dokumenti përmbaues nuk është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve, e sidomos duke pasur parasysh se lidhur me pretendimet nga kundërshtimi, debitori nuk ka ofruar asnjë provë të formës së shkruar që do të mbështetët pretendimet e tij, siç është paraparë në dispozitën e nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së, sipas dispozitës të cekur është paraparë se provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim për ndryshe prapësimi do të refuzohet.

Sa i përket pretendimeve të debitorit se borxhi i kreditorit është parashkruar, gjykata nuk i morri për bazë pasi që sipas nenit 360 të Ligjit për Marrëdhëniet të Detyrimeve Ligji Nr. 04/L-077, në të cilin theksohet se 1.Kërkesat të cilat parashkruhen për një (1) vit, 1.1 kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake “, andaj në rastin konkret borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit sipas propozimit për përmbarim në shumë prej 469.10 €, nuk është parashkruar ashtu siç pretendon debitori, pasi që ndërprerja e parashkrimit bëhet me pranimin e borxhit nga debitori përderisa debitori në emër të borxhit ka bërë pagesën energjisë së shpenzuar në intervale të caktuara kohore, ndërsa në vështrim të faturës së borxhit vërtetohet se borxhi në fjalë është për periudhën e vitit 2019, që përkon edhe me kohën e propozimit për përmbarim dhe urdhërin për përmbarim, me çka me një veprim të tillë është ndërprerë parashkrimi sipas nenit 368 paragrafi 2 i LMD-së.

**Gjykata e refuzoi** prapësimin e debitorit, pasi që kreditori propozimit për përmbarim ja ka bashkangjitur Ekstraktin e verifikuar nga librat afarist, gjegjësisht kartelën e klientit K.-..., në emër të debitorit, i cili është i vulosur me vulë origjinale, i cili tregon për pagesat që janë kryer kohe pas kohe nga debitori e sipas nenit 37 të LPP-së, i cili thotë : ***“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”***, i cili ekstrakt i plotëson të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 1., 1.2 të LPP-së.

Andaj në kuptim të nenit 5.5, 29 par. 1., 1.2, 69 paragrafi 4, 71, 73 paragrafi 3 të LPP-së, u vendos si në pikën **I** të dispozitivit të këtij AKTVENDIMI.

Në pikën **II** të dispozitivit të këtij Aktvendimi Gjykata është bazuar në nenin 77 paragrafi 5 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË**  
**PPP.nr.1/20, datë 22.12.2022**

**GJYQTARI**  
**Nehat Qelaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.